

KONTRATË PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR  
"LONDON FASHION GROUP " SH.P.K.

Sot me datë 3 nëntor 2023, ortaku themelues :

1. Znj.Frosina BOLLO , e bija e Stilianit , shtetase shqiptare lindur në Durrës më 15.03.1990 dhe banuese në Durrës , Rruga Baki Celmeta, lagja 11, Durrës, me kartë identiteti 038173255,

me vullnetin tim të lirë kam vendosur si më poshtë vijon :

- NENI 1 -

Të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar emërtuar " **LONDON FASHION GROUP**" sh.p.k.

Selia legale e shoqërisë është në rruga SHESHI LIRIA /3, Nr ap Nr 26, pranë Bashkisë Durrës. Shoqëria mund të hapë seli ose filiale të tjera në territorin shqiptar ose jashtë tij.

- NENI 2 -

Shoqëria zhvillon aktivitetin e vet në përputhje me këtë kontratë, statutin bashkëlidhur dhe ligjet materiale të Republikës së Shqipërisë.

- NENI 3 -

Objekti i shoqërisë konsiston në aktivitetin :

Import eksport mallrash, tekstile, këpucë, atlete, bizhu, aksesore të ndryshëm.

Prodhimin, tregtimin dhe shitjen përmes tregtisë elektronike (online), shitjes me shumicë dhe pakicë, brenda dhe/ose për llogari të palëve të treta,

Blerja, shpërndarja, prodhimi, tregtia, me shumicë dhe pakicë, përfaqësimi dhe komisioni, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj

Organizim eventesh si sfilata, ekspozita etj.

Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me qëllim fitimi me persona juridik e fizik të çfarëdo lloj tipi dhe sido që të jenë krijuar ato.

Si dhe të ushtroj çdo lloj aktiviteti tjetër kultural, financiar, tregtare, industrial, ndërtimi , Import Eksporti etj që do të shihen në interes të realizimit të objektit social të saj.

Shoqëria gjithashtu ka të drejtë të japi hua, financime për të tretë, për shoqëri që lidhen me të ose që kontrollohen nga ortakët.



Mundet gjithashtu të marri ndihma ose financime nga çfarëdo enti publik ose privat, shqiptar ose i huaj, nga institute bankare ose nga shoqëri që lidhen me të ose kontrollohen nga ortakët.

- NENI 4 -

-

Sipas ligjit shqiptar, shoqëria regjistrohet si person juridik dhe kryhen të gjitha formalitetet në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë.

Kohëzgjatja e shoqërisë fiksohet deri më 20 vjet dhe mundet të prishet para kohe ose të zgjatet një ose më shumë herë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

- NENI 5 -

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lek i ndarë në 1 pjesë.

Ortakët marrin pjesë në kapitalin social si më poshtë:

1. Znj.Frosina BOLLO 1 pjesë me vlerë 100.000 lekë ose 100% të kapitalit

- NENI 6 -

Pjesët e pjesëmarrjes në kapitalin shoqëror janë të papjestueshme.

Ato nënshkruhen, depozitohen totalisht nga ortakët në bazë të pjesëmarrjes së secilit në kapital. Çdo pjesë ka të drejtën e një vote. Pjesët janë lirisht të transferueshme vetëm pasi të jetë marrë miratimi me shkrim i të gjithë ortakëve.

- NENI 7 -

Ortaku që dëshiron të shesë pjesët tij të tretëve, duhet të njoftojë më parë ortakët të cilët gëzojnë të drejtën e parablerjes brenda 30 ditësh nga marrja dijeni. Në rast se blerja bëhet nga të tretë, ortaku që shet duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë emrin e blerësit dhe kushtet e shitjes.

- NENI 8 -

-

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

a) Asambleja e ortakëve.

b) Administratorët.

Aktiviteti, mënyra e organizimit të drejtimit, emërimi ose shkarkimi i drejtuesve si dhe probleme të tjera të rëndësishme do



të organizohen në bazë të statutit të shoqërisë që është pjesë përbërëse e kontratës dhe dokumenteve të tjera që do të aprovohen nga Asambleja e ortakëve.

Vendimet e Asamblesë janë të vlefshme në rast se do të aprovohen nga shumica relative e kapitalit. Për probleme që lidhen me mbledhje të jashtëzakonshme, kërkohet vendimi i ortakëve që kanë 50% + 1% të kapitalit.

- NENI 9 -

Asambleja e ortakëve emëron si administratore të shoqërisë nga 1.11.2023 deri 1.12.2026 z. Frosina BOLLO , mbajtëse e kartës së identitetit 038173255

Administratorët , për probleme të veçanta, mund të delegojnë persona të tjerë me prokurë të veçantë ose të përgjithshme.

- NENI 10 -

Aktiviteti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti. Me mbylljen e aktivitetit vjetor do të bëhet bilanci dhe llogaritë fitim/humbje. Fitimi i realizuar, pasi të zbriten rezervat ligjore, do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me vlerën e pjesëmarrjes së secilit në kapitalin social, në rast se ortakët nuk vendosin për krijimin e rezervave të tjera.

- NENI 11 -

Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo motivi sipas kriterëve të përcaktuara në statut. Në rastin e prishjes së shoqërisë për çfarëdo motivi qoftë, emërimi dhe revokimi i likuidatorëve i takon Asamblesë së Ortakëve e cila përcakton edhe kompetencat e tyre.

- NENI 12 -

Mosmarreveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate palët do ti zgjidhin në mirëkuptim ndërmjet tyre. Në rast të kundërt gjykata kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë gjykata e rrethit Tiranë.

- NENI 13 -

Kjo kontratë u përpilua në katër ekzemplarë në gjuhën shqipe të gjitha tekstet kanë fuqi të barabartë, njëra depozitohet në zyrën e Noteris Durrës.

Durrës, më 3 nëntor 2023

O R T A K U

*Frosina Bollo*  
Frosina BOLLO

*[Signature]*